



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Nr. 11575 prot.

Tiranë, më 12.09.2018

Lënda: Përcillet informacion

**MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, 1000

Tiranë

**Për dijeni: AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Adresa: Qyteza Pejton, Rruga Mujo Ulqinaku 18

Prishtinë

**AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Adresa: Rr. Donika Kastrioti, vila nr. 6, 1001

Tiranë


**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Adresa: Ish Ndertesa e Germise, 10000, Prishtinë

Republika e Kosovës ✓

Në kuadër të angazhimeve të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e kushteve të jetesës duke nxitur përmirësimin dhe sigurinë në infrastrukturën rrugore kombëtare, bashkëlidhur ju përcjellim për dijeninë Tuaj informacionin mbi skemën zbritëse të taksës së autostradës Milot Morinë për përdoruesit e shpeshtë të saj, në kuadër të kontratës së koncesionit “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot Morinë” si dhe CD me informacionin e nevojshëm. Kjo skemë zbritjesh e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e skemës zbritëse të taksës së autostradës Milot-Morinë”, për përdoruesit e shpeshtë do të fillojë të zbatohet duke filluar nga data 17.9.2018.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



**MINISTRI**  
**DAMIAN GJIKNURI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

### Informacion mbi skemën zbritëse të taksës së autostradës Milot Morinë, për përdoruesit e shpeshtë të saj

Në skemën e zbritjes për përdoruesit e shpeshtë do të përfshihen tre kategori:

1. Automjetet e banorëve të Qarkut Kukës
  2. Autobusët nga dhe për në Qarkun e Kukësit
  3. Automjetet e përdoruesve të shpeshtë
- ❖ Në kategorinë e parë të automjeteve të banorëve të Qarkut Kukës përfshihen Klasa A dhe B e automjeteve për përdorim personal të regjistruara në Qarkun Kukës. Këto automjete do të pajisen me OBU (On board unit) të sistemit Digital Pass dhe në OBU nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete për familje. Tarifa e rrugës për 1 kalim për të gjithë automjetet e regjistruara në Qarkun Kukës për klasën A do të jetë **50 lekë me TVSH** dhe për automjetet e klasës B do të jetë **100 lekë me TVSH**. Kjo tarifë do të jetë e kufizuar për jo më shumë se **44 kalime në muaj dhe e vlefshme për tu përdorur brenda periudhës 1 mujore nga data e kryerjes së pagesës për këto kalime** (nëse ky numër tejkalohet, atëherë përdoruesi i OBU-t do të duhet të tarifohet sipas vlerës përkatëse të parashikuar në pikën 11.4.5 të kontratës së koncesionit). Shpenzimet e kryera nga shoqëria koncesionare për koston e pajisjes (OBU) të sistemit Digital Pass cila do tu jepet falas banorëve të Qarkut Kukës do të përballohet nga pagesa e parashikuar në pikën 11.8 (b) të Kontratës së Koncesionit. Përdoruesit e Qarkut Kukës do të para blejnë në mënyrë të përshkallëzuar **deri në 44 kalime** me këtë tarifë të reduktuar.
  - ❖ Në kategorinë e Dytë përfshihen autobusët nga dhe për në Qarkun e Kukësit. Tarifa e rrugës për këta autobusë do të jetë prej **100 lekë me TVSH për 1 kalim**;
  - ❖ Në kategorinë e tretë përfshihen përdoruesit e shpeshtë të autostradës Milot Morinë automjetet e të cilëve do të pajisen me OBU (kostua e OBU-t do të përballohet nga këta përdorues të shpeshtë të autostradës) dhe nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete. Lidhur me kategorinë "përdorues të shpeshtë" pa dallim mjeti, ulja e tarifës do të bëhet për numër kalimesh pasi sistemi do të funksionojë në mënyrë të tillë që do të regjistrojë numrin e kalimeve për çdo mjet.
    - Nga 20 deri në 30 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 10%;
    - Mbi 30 deri në 50 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 20%;
    - Mbi 50 deri në 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 30%;
    - Mbi 60 kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 40%;

Kjo skemë zbritjesh për përdoruesit e shpeshtë do të fillojë të zbatohet duke filluar nga data 17.9.2018.